

# A K T T H E M E L U E S

I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE “JOHANITERI” SH.P.K.



Ne kerkuesit :

- Robert XHAFERRI, i biri i Maliq, dtl.23.07.1967, banues Shijak, Durres.

- Arjan XHAFERRI, i biri i Maliq, dtl. 03.04.1977, banues Shijak, Durres,

- Enkeleda RAMA, e bija e Selami, dtl.15.10.1970, banuese Shijak, Durres.

mbeshtetur ne Ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit ” dhe te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 “ Per shoqerite tregetare ” krijojme shoqerine tregetare private me perjegjesi te kufizuar “ **JOHANITERI** ” dhe me aktin themelues te saj si vijon:

## F O R M I M I

### NENI 1

Formohet shoqeria tregetare private e quajtur “ **JOHANITERI** ” sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

## SELIA E SHOQERISE

### NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private “ **JOHANITERI** ” sh.p.k. do te jetë : Shijak, Durres.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

### NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:

- Sherbim me televizion Lokal privat.
- Import-eksport paisje e prodhime televizive.
- Transport maltra brenda e jashte vendit.

## NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape objekte e njesi transmetimi e sherbimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.



## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkaku.

## KAPITALI I SHOQERISE

## NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregetare private "**JOHANITERI**" sh.p.k. do te jete 100.000 leke, dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise te ndare ne pjesete barabarta si vijon:

- <b>Robert XHAFERRI</b>	.....	33 %
- <b>Arjan XHAFERRI</b>	.....	34 %
- <b>Enkeleda RAMA</b>	.....	33 %

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve. Kuotat e pjesemarresve ne kapital jane te gjitha te emeruare dhe te pandashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

## NENI 7

Ortaket duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruajne sekretin e saj dhe te mos demtojne interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.

## DREJTAMI I SHOQERISE

## NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, caktuar nga ortaket themelues te shoqerise, z. **Robert XHAFERRI**, i cili eshte edhe perfaqesuesi ligjor i saj.

## NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne proporcione me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar.

## NENI 10

Ortaket themelues kane te drejte te emerojne edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ata kane te drejte te caktojne financier, likuidator per problemet e shoqerise, si edhe te pajtojne persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

## NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne gjykaten e shkalles se pare Durres.

## NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakoneshme, me tekstin per rrethin e saj.

## NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plete te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqerive tregetare".

## NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

## NENI 15

Akti i themelimit, u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare private  
**"JOHANITERI" sh.p.k.**

Akti i themelimit nenshkruehet rregullisht nga ortaket themelues.


ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**"JOHANITERI" sh.p.k**

Robert XHAFERRI

Enkeleda RAMA

Arjan XHAFERRI

Robert XHAFERRI Enkeleda RAMA Arjan XHAFERRI  
ROBERT XHAFERRI ENKELEDA RAMA ARJAN XHAFERRI  


# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “JOHANITERI”

Ne baze te ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit” dhe te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, “Per shoqerite tregetare”, me vullnetin tone te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit Themelues:

- **Robert XHAFERRI**, i biri i Maliq, dtl.23.07.1967, banues Shijak, Durres.
- **Arjan XHAFERRI**, i biri i Maliq, dtl. 03.04.1977, banues Shijak, Durres,
- **Enkeleda RAMA**, e bija e Selami, dtl.15.10.1970, banuese Shijak, Durres.

hartojme Statutin e shoqerise si me poshte:

### EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

#### NENI 1

Shoqeria emertohet “**JOHANITERI**” sh.p.k.

#### NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private “**JOHANITERI**” sh.p.k. do te jete : Shijak, Durres.

#### NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.

#### NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

- Sherbim me televizion Lokal privat.
- Import-eksport paisje e prodhime televizive.
- Transport mallra brenda e jashte vendit.

## KAPITALI I SHOQUERISE

### NENI 5

Kapitali fillestar i shoquerise tregetare private “**JOHANITERI**” sh.p.k. do te jetë 100.000 leke, dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoquerise te ndara ne pjesë si vijon:

- Robert XHAFFERRI	.....	33 %
- Arjan XHAFFERRI	.....	34 %
- Enkeleda RAMA	.....	33 %

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve. Kuotat e pjesemarresve ne kapital jane te gjitha te emeruare dhe te pandashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

### NENI 6

Ortaku qe ka ndermend te shese kuotat e tij, teresisht apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortaket e tjere te shoquerise. Ortaket e tjere kane te drejten e blerjes se pare. Kete te drejte ata duhet ta ushtroje brenda 30 diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos-ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortaku qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favoreshme se sa ato te ofruara ortakeve te tjere te shoquerise.

### NENI 7

Kapitali i shoquerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujteshme ose te pa lujteshme etj, te nevojeshme per ushtrimin e aktivitetit te shoquerise.

### NENI 8

Kuotat e kapitalit fillestar jane te siguruara nga ortaket themelues te shoquerise dhe te regjistruala ne librin e llogarise te shoquerise.

### NENI 9

Shoqueria tregetare “**JOHANITERI**” sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqueria tregetare “**JOHANITERI**” sh.p.k. gezon te drejta, sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

## NENI 10

Shoqeria tregetare “**JOHANITERI**” sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoquerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoquerise, vetem ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqeria nuk perggjigjet per detyrimet qe ortaket kane patur para se ajo te krijohet.

## NENI 11

Heqja dore e nje ortaku nga bashkepunimi nuk e çliron ate (ortakun e larguar) nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohe. Po keshtu ai fiton edhe te drejtat qe jane krijuar para largimit te tij.

## NENI 12

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve, ne proporcione perqindjen e kapitalit te investuar, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortaket nuk mund te kaloje kuotat e percaktuara ne kapitalin fillestar. Rritja e kapitalit nga ortaket do te behet vetem me vendim unanim te Asamblese se ortakeve.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### NENI 13

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, caktuar nga ortaket themelues te shoquerise z. **Robert XHAFERRI**, i cili eshte edhe perfaqesuesi ligjor i saj.

### NENI 14

Organet drejtuese te shoquerise jane:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratoret.
- Komisioni i revizionimit.

Vendimet qe mer Asambleja jane te detyrueshme per ortaket e shoquerise.

Asambleja thirret sa here qe e shohin te aresyeshme ortaket themelues te shoquerise, por detyrimisht ne Dhjetor per te miratuar programi e veprimtarise per vitin e ardhshem dhe ne mars per te miratuar bilancin kontabel te vitiit te meparshem.

## NENI 15

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme kur te jene pranuar unanimisht nga ortaket themelues te shoqerise.

## NENI 16

Hijne brenda detyrave dhe kopetencave te Asamblese se ortakeve themelues si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarise vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria.
6. Pranimet ne puna dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise.
8. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

## NENI 17

Administratori jo ortak perveç detyrave qe i caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto detyra e te drejta:

1. Te mire-administroje pasurine e shoqerise.
2. Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortaket themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
4. Te pergjigjet per demet qe i sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marreveshjes te bere me ortaket themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithcka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.
7. Te kryeje te gjitha veprimet bankare qe kane te bejne me llogarine e shoqerise.

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

## NENI 18

Shoqeria ka te drejte:

1. Te kryej veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise

2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punonjes te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

#### NENI 19

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.
2. Te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria.
3. Te siguroje punonjësit e saj.
4. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektoje standartet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

#### MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

#### NENI 20

E gjithe veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

#### NENI 21

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni finanziar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

#### NENI 22

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### NENI 23

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.


#### NENI 24

Nga fitimet e realizuara gjate vitit finanziar, shoqeria, pasi ben zbritjet e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5 % te fitimit, me te cilin krijohet fondi " Rezerve e domosdoshme ", deri sa ky fond te arrije ne masen 10 % te kapitalit themeltar.

## NENI 25

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondev te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdom ortakeve themelues te shoqerise. Fitimi i realizuar nga shoqeria do te ndahet ne mes te ortakeve te saj ne perputhje me kapitalet e investuara, por pa kaluar perqindjet e percaktuara ne kapitalin fillestar.

Konvertimi i parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shtetit shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.



## DISPOZITA TE VECANTA

## NENI 26

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

## SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

## NENI 27

Shndrrimi i shoqerise “**JOHANITERI**” sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

## NENI 28

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese se ortakeve

Ne keto raste, pronaret e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

Likuidatori eshte perjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik e juridik, duke likuiduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria. Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkonte ortakeve themelues te shoqerise qe te derdhin teresisht kuotat qe i takojne atyre.

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 29

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaket themelues, si edhe ligjeve te vecanta te legjpcionit shqiptar. Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti-behen me menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.


NENI 30

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'u shperndare organeve kompetente dhe një kopje mbetur ne dokumentacionin base te shoqerise tregetare private  
**"JOHANITERI"** sh.p.k.


### ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**"JOHANITERI"** sh.p.k.


Robert XHAFERRI



Enkeleda RAMA



Arjan XHAFERRI



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E TIRANES

Nr....7663....Rep

Nr.....Kol

Tirane me 06-09-2005

### VERTE TIM

Sot me dt. 06-09- 2005 u paraqiten para meje zz. **Robert XHAFERRI**, **Enkeleda RAMA** dhe **Arjan Xhaferri** madhore, te panjohur personalisht prej meje, per identitetin e te cileve u njoha nga dokumentet identifikuuese, te cilet deklaruan se sa me siper eshte hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plete dhe nenshkruehet pa verejtje ne pranine time dhe une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTE RE  
SILVANA MERKO

